



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 29, Datë 26.03.2009

PËR

**NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR KONFIDENCIALITETIN NË
AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në rregulloren “Për konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” miratuar me vendimin e Bordit nr. 114 datë 11.09.2008, bëhen këto ndryshime si më poshtë:

Në nenin 4, pika 4. 3 germa b, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Kur personi ka firmosur një deklaratë që vërteton se informacioni i marrë do të mbetet konfidencial gjatë gjithë kohës që ky informacion klasifikohet si konfidencial nga Autoriteti dhe që personi është ligjërishit përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit gjatë kësaj periudhe”.

Në nenin 4, pas pikës 4.8. shtohet pika 4.8.1 me këtë përmbajtje:

“ Informacioni konfidencial që merret nga Autoritetet e huaja, përfshirë këtu dhe vetë kërkesën për dhënien e informacionit nga AMF ose kërkesën e AMF-së për marrje informacioni nga Autoritetet e huaja, do të klasifikohet si informacion konfidencial. Ky informacion do të mbetet konfidencial përgjithmonë, ose deri atëherë kur Autoriteti i huaj do t’i japë leje AMF-së për ta deklasifikuar informacionin si konfidencial”.

Në nenin 4, pika 4.11. ndryshohet me këtë përmbajtje:

Anëtarët e Bordit dhe punonjësit e AMF-së me fillimin e marrëdhënieve të punës kanë detyrimin të nënshkruajnë deklaratën për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit për

sa kohë që ky informacion do të jetë klasifikuar si konfidencial në bazë të kësaj rregulloreje.

Anëtarët e Bordit dhe punonjësit e AMF-së, kur shkëputin marrëdhëniet e punës me institucionin, nënshkruajnë deklaratën se detyrohen të ruajë konfidencialitetin e çfarëdo informacioni të përftuar gjatë ushtrimit të detyrës, për aq kohë sa konsiderohet i tillë si dhe i ndalohet marrja me vete e informacionit dokumentar dhe elektronik të klasifikuar jopublik.

Në nenin 4 shtohet pika 4.12 me këtë përmbajtje:

Anëtarët e Bordit dhe punonjësit e AMF-së, që aktualisht punojnë në institucion nënshkruajnë deklaratën për ruajtjen e konfidencialitetit, siç parashikohet më lart.

Në nenin 8 pika 8.2, hiqet.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**